



Datë: 27.03.2025  
Numër Protokolli: 2269/2025

A.nr.182/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.182/2025 të datës 23.01.2025 të parashtruar nga ankuesi, I.B., kundër organit të punësimit/Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.182/2025, e datës 23.01.2025 e parashtruar nga ankuesi I.B.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, I.B.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 23.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 483/2025, të regjistruar nën shenjë A.nr.182/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 8537 të datës 17.12.2024, të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1511/2025 të datës 07.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: *Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 483/2025 të parashtruar nga ankuesi më datë 23.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokolli 7610 të datës 01.11.2021; Kërkesë me numër protokolli 5480 të datës 02.09.2024; E-mailin e datës 17.09.2024; Vendimin A.nr.1412/2024 të datës 01.11.2024; Parashtresën me numër protokolli 35/2025 e datës 06.01.2025; Vendimin me numër protokolli 8597, të datës 17.12.2024 nga Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; Provat e administruara të lëndës A.nr.1412/2024. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokolli 37645 të datës 04.12.2014, është punësuar në pozitën e punës *Inspektor i Veterinarisë*, dhe atë pranë

Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit të Komunës së Kamenicës, ndërsa përmes Vendimit me numër protokolli 02/10610 të datës 12.04.2019, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, i njëjti është transferuar në pozitën e *Inspektorit Sanitar*.

Tutje ankuesi, sipas Vendimit me numër protokolli 7312 të datës 22.10.2021, është transferuar nga Komuna e Kamenicës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, dhe atë në pozitën e *Inspektorit Fito sanitar*, ndërsa i njëjti përmes Vendimit me numër protokolli 7610 të datës 01.11.2021, është transferuar në pozitën e *Inspektorit Sanitar*, në organin e njëjtë të punësimit. Më tej, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes Memorandumit të Bashkëpunimi të datës 12.10.2023, mes Ministrisë së Shëndetësisë, ka realizuar transferimin e *Inspektorëve Sanitar* në këtë të fundit, si për rrjedhojë edhe ankuesin.

Ankuesi përmes Kërkesës me numër protokolli 5480 të datës 02.09.2024, i është drejtuar Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me kërkesën për pagesë të shpenzimeve të udhëtimit, ndërsa kjo e fundit, më datë 17.09.2024 ankuesit përmes shkresës elektronike zyrtare i ka kthyer përgjigjen në raport me kërkesën e tij, ashtu që kjo e fundit në përgjigjen e saj në fakt nuk ka shqyrtuar dhe as nuk ka vendosur lidhur kërkesën e ankuesit mbi bazën e dispozitave ligjore të aplikueshme për çështjen konkrete, mirëpo vetëm ka përshkruar dispozitat e nenit 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nga rrjedh se në rrethanat e rastit konkret Përgjigja e Njesisë për Menaxhimin se Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, në fakt nuk është akt administrativ që ka zgjedhur apo ka vendosur lidhur me kërkesën e palës ankuese, pasi që përgjigja në fjalë e ka mohuar pretendimin e palës ankimore lidhur me të drejtën e tij të supozuar sikurse në kërkesën e datës 02.09.2024, pa mbështetje të dispozitave ligjore të aplikueshme për rastin konkret si dhe pa një arsyetim përmbajtjesor siç parashihet legjislacionin në fuqi.

Ndërsa, ankuesi kundër përgjigjes së sipër theksuar me 18.09.2024, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për realizimin e kompensimit material të shpenzimeve të udhëtimit, dhe atë në shumën e përgjithshme prej 4942.08 € , për periudhën nga data 01.08.2021 deri më datë 01.11.2023.

Këshilli përmes Vendimit A.nr.1412/2024 të datës 01.11.2024, kishte kthyer lëndën e ankuesit në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, ndërsa Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes Vendimit me numër protokolli 8597 të datës 17.12.2024, ka konstatuar se nuk ka bazë ligjore për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në rastet kur vendbanimi i nëpunësit është në distancë më se 100 km.

Ankuesi, kundër Vendimit të lartë theksuar të cilin rezulton se e ka pranuar më datë 20.01.2025, më datë 23.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, rrjedhimisht i njëjti duke u mbështetur mbi dispozitat e Ligjit Nr.08./L-197 për Zyrtarët Publikë, kërkon kompensimin në vlerën e përgjithshme prej 4942.08 Euro, sikurse në kërkesën e parashtruar tek organi i përkatës i punësimit dhe në ankesën e datës 18.09.2024.

Kolegji Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me kompensimin material për shpenzimin e udhëtimeve nga data 01.08.2021 deri më datë 01.11.2023, ju referua dispozitave ligjore të aplikueshme për periudhën kohore kontestuese, gjegjësisht Ligjit Nr.06/1-114 për Zyrtarët Publik, i cili sipas Nenit 52 (Transferimi i përkohshëm) përcakton se: "1.Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të

*përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës. 2. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 2.3. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil. 3. Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: 3.1. kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil. 4. Nëpunësit civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, në një lokacion tjetër, i cili është më i largët se sa vendi i tij i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësin....” dhe Nenit 53 (Transferimi i përhershëm), ku përcaktohet se: “1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: 1.1. të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; 1.2. e shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj; 1.3. të përfundimit të pezullimit me kërkesë të nëpunësit civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës.”, rrjedhimisht sipas këtyre dispozitave ligjore të aplikueshme rezulton se nëpunësi civil kompensimin material për shpenzimet e udhëtimit mund ta realizoj vetëm nëse transferimi i tij është i përkohshëm, ndërsa në rastin konkret është fakt i pa kontestueshëm se ankuesi nga Komuna e Kamenicës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk është transferuar përkohësisht.*

Ndërsa, po ashtu duke u bazuar legjislacionin në fuqi në të cilin ankuesi e mbështet ankesën e tij, përkatësisht në paragrafin 4 të nenit 63 të Ligjit Nr.08./L-197 për Zyrtarët Publikë (Transferimi i përkohshëm) ku përcaktohet se: 4. Nëpunësja/i civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, i cili është më i largët se sa vendi i saj i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësin/in.; dhe nenin 65 paragrafi 4, 5 dhe 6, ku përcaktohet se: “4. Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil. 5. Transferimi i nëpunëses/it civil në një institucion tjetër të shërbimit civil, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunëses/it dhe me marrëveshje në mes të institucioneve. 6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste: 6.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor e pamundëson transferimin; 6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunëses/it civil; 6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin.”, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm ngase nuk ka mbështetje ligjore, sepse sipas këtyre dispozitave ligjore në fuqi parashihet kompensim vetëm në rastin e transferimit e përkohshëm, ndërsa siç u theksua edhe më sipër transferimi i ankuesit është i përhershëm, dhe se po ashtu ankuesi vetë deklaroi se për vajtje-ardhje në punë nga Komuna e Kamenicës deri në Komunën e Gjilanit janë gjithsejtë rreth 52 km.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.182/2025**

**Atdhe GASHI**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit I.B.;
- Udhëheqëses së Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.